



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 06
Prishtinë, më 08 shkurt 2010, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikolic, Gani Koci, Arsim Rexhepi, Riza Smaka, Synavere Rysha, Enis Kervan.

Mungoi: Anita Morina.

Të pranishëm: Lage Olofsson - auditor i përgjithshëm, nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, KIPRED (staf mbështetës) Artan Venhari dhe Qemajl Marmullakaj, OSBE - Lejla Selimi dhe NDI - Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02 shkurt 2010;**
- 3. Rekomandimi për auditor të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2009;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02 shkurt 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 02 shkurt 2010.

3. Rekomandimi për auditor të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2009

Haki Shatri – I njoftoi anëtarët e Komisionit se mbledhja ishte organizuar me orar jo të rregullt, që çështja e paraparë për shqyrtim të procedohej sa më shpejt. Komisioni do të diskutojë për t'i dhënë rekomandim Kuvendit për auditorin, i cili do ta bëjë auditimin e pasqyrave financiare të auditorit të përgjithshëm. Në këtë mbledhje të ftuar e kemi edhe auditorin e përgjithshëm. Na janë shpërndarë ofertat e tre ofertuesve. Si Komision mund t'ia bëjmë një rekomandim Kuvendit. Hap diskutimin.

Gani Koci – Lidhur me nismën procedurale për zgjedhjen e auditorit të jashtëm nga ana e auditorit të përgjithshëm, tha se është në kundërshtim me Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, përkatësisht në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit. Sipas këtij neni “...dhe të cilët zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës...”. Pra, i gjithë procesi i kërkesës, i ofertimit dhe i përzgjedhjes bëhet në Kuvend. Kuvendi në buxhetin e vet ka paraparë një shumë të caktuar parash, për zgjedhjen e auditorit që do të bëjë auditimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Ky proces duhet të zhvendoset nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Kuvend. Zgjedhja e auditorit të jashtëm duhet të bëhet jashtë Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Riza Smaka – Ne duhet ta përfillim nenin 6 të Ligjit për themelimin e zyrës së auditorit të përgjithshëm. Padyshim se do të kishte konflikt interesi, sikur auditori i përgjithshëm ta angazhonte drejtpërdrejt auditorin e vet. Duhet ta propozojmë nismën e Kuvendit për këtë çështje.

Arsim Rexhepi – Tha se propozimet për auditor të proceduara nga auditori i përgjithshëm të mos diskutohen fare dhe ne ta iniciojmë në Kuvend zgjedhjen e auditorit të jashtëm në përputhje me Ligjin. Adresa ku do të duhej të vinin ofertat është Kuvendi i Kosovës. Mënyra, si është proceduar ky material, nuk është në përputhje me Ligjin.

Haki Shatri – Sipas Ligjit auditori i përgjithshëm nuk e zgjedh auditorin e jashtëm, por Ligji nuk i ka përcaktuar procedurat teknike të procedimit të çështjes. Është e vërtetë që buxheti për zgjedhjen e auditorit të jashtëm është paraparë në kuadër të buxhetit të Kuvendit. Ky komision mund vetëm t'i rekomandojë Kuvendit. Auditori i përgjithshëm nuk e ka bërë zgjedhjen, por vetëm e ka shpallur tenderin, i ka marrë ofertat dhe i ka proceduar në Kuvend. Është çështje e Komisionit a do t'ia rekomandojë Kuvendit përzgjedhjen e ndonjërit prej këtyre ofertuesve apo do t'ia kërkojë përsëritjen e procedurës.

Gani Koci – Zyra e Auditorit e ka zhvilluar një proces në kundërshtim me normat ligjore. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e ka bërë një përzgjedhje dhe e ka proceduar në Kuvend. Tërë procesi duhet të zhvendoset në Kuvend. Komisioni duhet t'ia rekomandojë Kuvendit që të nisë procedurën e shpalljes së kërkesës për auditim e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Safete Hadergjonaj – Tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa jo rastësisht ka ndarë mjete që të bëhet një auditim i ZAP-it. Për ndarje të këtyre mjeteve jemi bazuar në nenin 6 të Ligjit për themelimin e zyrës së auditorit të përgjithshëm. Sikur të mos ishim bazuar në këtë nen, do t'i kishim paraparë mjetet në kuadër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm e jo në kuadër të Kuvendit. Mjetet për Zyrën e Auditorit duhet të transferohen prej një organizate buxhetore në organizatën tjetër buxhetore. Të gjithë e dimë sa probleme dalin kur bëhet transferi i mjeteve. Në ligjet e buxheteve të kaluara kjo ka qenë e ndaluar, edhe pse në këtë vit është bërë një lëshim. Nuk them se Zyra e Auditorit ka bërë përzgjedhje të keqe, mirëpo ajo ka mbajtur mbledhje, ka bërë oferta, ka bërë përzgjedhje, çka do të thotë se është shkelje e Ligjit. Propozoj që kjo kërkesë të kthehet në Kuvend dhe të fillojë procedura.

Kosara Nikolic – Tha se është e mjaftueshme ajo çka thotë neni 6, sipas të cilit auditorët e jashtëm zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës. Nëse e vlerësojmë që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka vepruar në kundërshtim me Ligjin, atëherë ne jemi ata të cilët miratojmë ligje. Në bazë të kësaj duhet ta ndërpresim këtë dhe të kërkojmë që përzgjedhja të bëhet në përputhje me procedurën e rregullt.

Synavere Rysha – Nuk mendon se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka bërë ndonjë shkelje të madhe. Përkundrazi, sipas saj, kjo zyrë me procedurat që i ka ndërmarrë e ka lehtësuar procesin. Ligji ka paqartësi, sepse nuk i ka saktësuar procedurat e përzgjedhjes. Në këtë rast, kur auditori i ka përzgjedhur tri oferta, e ka lënë një punë të përgjysmuar, sepse përsëri brenda Kuvendit duhet të formohet komision. Zyra e Auditorit ka vepruar njësoj sikur që është bërë përzgjedhja e zyrtarëve të tjerë të lartë nga agjencie të ndryshme. Propozoi që kjo çështje të shtyhet, që ta gjejmë një model më të mirë të mundshëm dhe të mos veprojmë në kundërshtim me Ligjin.

Haki Shatri – Kërkesa për auditimin e auditorit të përgjithshëm ishte e mëhershme dhe nuk është bërë asnjëherë. Nuk është bërë ndonjë shkelje e Ligjit, sepse asnjë vendim nuk është marrë. Kërkesa nuk është për auditimin vetëm për vitin 2009, por komplet për periudhën e kaluar, domethënë prej themelimit të kësaj zyre. Duhet ta kemi një mendim të Kuvendi, se a ka mekanizëm të caktuar për këto raste. Ne jemi ata të cilët do të vendosim lidhur me këtë propozim. Përzgjedhja dhe emërimi janë përcaktuar qartë me Ligj, por procedura paraprake nuk është përcaktuar.

Gani Koci – Tha se procesi i fillimit të përzgjedhjes së auditorit të jashtëm për zyrën e auditorit të përgjithshëm duhet të nisë në Kuvend. Procedurat brenda Kuvendit janë çështje të tjera, të cilat diskutohen brenda tij. Këto janë çështje teknike. Zyra e Auditorit ka ndërmarrë një veprim që nuk është dashur ta ndërmerre. Komisioni duhet t'i rekomandojë Kuvendit t'i nisë procedurat për shpalljen e konkursit – tenderit publik të përzgjedhjes së auditorit të jashtëm.

Riza Smaka - Tha se nga teksti i dispozitës 6 del se Kuvendi është titullari që e nis dhe e procedon këtë çështje. Fjala është për auditimin e auditorit të përgjithshëm. Këtu apriori përjashtohet çfarëdo ndërhyrje e auditorit në këtë procedurë. Propozoj t'i rekomandojmë Kuvendit ta zbatojë dispozitën 6 të Ligjit për themelimin e zyrës së auditorit të përgjithshëm, të cilën nuk e ka bërë deri më tani.

Lage Olofsson - auditor i përgjithshëm – Në mars të vitit të kaluar e kam nxjerrë një raport vjetor të performancës që i ka përfshirë edhe pasqyrat vjetore financiare për vitin 2008. E kam proceduar këtë raport në Komisionin për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës, si bazë për dialog të ardhshëm të buxhetit. Menjëherë pas kësaj, në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, kam thënë se këto pasqyra vjetore financiare, nuk të audituara. Me këtë, para dhjetë muajsh, e kam nxitur këtë komision ta caktojë një auditor, që të kryente auditimin sa më shpejt. Asgjë nuk ka ndodhur. Dëshiroj që Kosova të ketë pikë sa më të mira në të gjitha vlerësimet që i bëhen, përfshirë edhe Raportin e Progresit. Një prej çështjeve të vogla që mund t'i ndihmojë këtij vlerësimi, që raporti vjetor i performancës që do ta nxjerrim në prill, është të përfshihen edhe pasqyrat vjetore financiare të audituara nga një kompani e cila i përmbush kriteret e parapara me ligj. Për shkak se nuk ka ndodhur asgjë në këtë drejtim, e kam ofruar mbështetjen për Komisionin, pa dashur të përzihe mi ose të kemi ndonjë konflikt interesi në këtë përzgjedhje. Ne kemi filluar me këtë proces të prokurimit. Ju keni tre ofertues të përgjegjshëm. Ne i kemi përzgjedhur ata të cilët i kanë përmbushur kriteret. Nuk i kemi emëruar ose zgjedhur ata. Ne vetëm po jua ofrojmë mundësinë që këtë ta bëni ju. Nuk është shkelje ligji. Ligji nuk e përcakton procedurën si duhet të arrihet deri këtu. Dëshiroj ta nxis Komisionin të mendojë dhe mos e zvarritë këtë proces, të mos vijë puna që të kemi më pak pikë në Raportin vjetor të Progresit. Kjo punë duhet të marrë fund deri në mes të marsit, nëse mund t'i fusim këto pasqyra në raport.

Arsim Rexhepi – Para së gjithash duhet të jemi përgjegjës para Ligjit. Ligji thotë se i gjithë procesi duhet të zhvillohet në Kuvend. Çdo diskutim rreth kësaj çështjeje do të ishte konotacion nënçmues për audiencën. Propozoj të votohet për dy propozimet dhe Kuvendi në një afat sa më të shkurtër ta procedojë çështjen ashtu siç e parasheh Ligji.

Gani Koci – Çështja ka të bëjë me respektimin e normës. Një institucion jokompetent ka ndërmarrë një procedurë dhe kjo çështje duhet të kthehet të organi kompetent për fillimin e procedurës. Në këtë rast organ kompetent është Kuvendi, i cili ka të drejtë që një auditor ta zgjedhë për një ose për dy vjet, por jo më shumë se pesë vjet. Konstatimi i Komisionit duhet të jetë: *Procedurat e zhvilluara nga auditori për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm nuk janë në përputhje me Ligjin dhe se ky institucion nuk është kompetent për përzgjedhje dhe i gjithë procesi i kthehet kuvendit.* Edhe në raport të progresit vihet një pikë pozitive, kur thuhet se është respektuar ligji.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, ka vendosur t'i rekomandojë Kuvendit ta nisë procedurën e përzgjedhjes së auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2009, në pajtim me nenin 6 të Ligjit për themelimin e zyrës së auditorit të përgjithshëm nr. 03/L-075.

4. Të ndryshme

a) Diskutim rreth çështjes së akomodimit të ZAP

Haki Shatri – I Njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me shkresën e ZAP. Kjo shkresë i është drejtuar edhe Komisionit për Buxhet. ZAP-i ka pasur një marrëveshje të nënshkruar me Ministrinë e Administratës Publike që t'ia caktojë zyrat për akomodim, diku ku nuk paguhet qira. Kur kemi diskutuar për buxhetin e vitit 2010, nuk kemi paraparë shuma për qira. Si duket Qeveria nuk është e gatshme ta respektojë atë marrëveshje. Qiraja mujore është 14 mijë euro.

Gani Koci – Tha se Komisioni për Buxhet në mbledhjen radhës do të diskutojë për këtë çështje.

Riza Smaka – Është shumë shqetësues fakti që shoqëria politike lejon që të paguhet qira për lokale në këtë rast të ZAP-it 14 mijë euro, për muaj. Mesatarisht maksimalisht një metër katror paguhet 5 euro. Sa metra katror qenkan aty? A thua ky objekt është objekt i ndërtuar legalisht apo ilegalisht? ZAP është institucion të cilin ne e respektojmë dhe e mbështesim me mundësitë tona, por është fjala për një skandal. Qeveria ka pas deklaruar se do ta ndërpres këtë dhe kam qenë optimist se do ti ndërpresin këto qira diskutabile. Për këtë temë do të ishte mirë të diskutojmë edhe në një nga seancat, sepse është fjala për para publike. A thua këto para shkojnë të gjitha për qira? Dyshimet janë të bazuara.

b) Diskutim rreth shkresës së proceduar në Komisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit për mandatin dhe rregulloren e punës së Komisionit

Gani Koci - Tha se mandati i këtij komisioni është t'i shqyrtojë dhe t'i vlerësojë të gjitha raportet e audituara financiare dhe të performancës të të gjitha agjencive buxhetore. Ky komision me vetnismë mund të kërkojë që të bëhen auditime dhe kontrole nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Safete Hadergjonaj – Tha se Komisioni duhet ta ketë materialin për të cilin është diskutuar në Komisionin për Legjislacion dhe në Komisionin për Mandate dhe Imunitete. Ne kemi diskutuar lidhur me këtë çështje. Diskutimet në komisionet e tjera janë të paarsyeshme dhe të panevojshme.

Riza Smaka – Tha se i kemi caktuar autorizimet tona. Vetë emri i Komisionit flet për mbikëqyrjen – kontrollimin në kuptimin e mirëfilltë. Për mua është shumë më shqetësuese kur Kosova paguan 14 mijë euro për një nga agjencitë.

Haki Shatri – Në takimin që e kemi pasur për fushëveprimin e Komisionit, saktësisht është shkruar shkresa për atë që jemi pajtuar. Kërkesa është teknike – thjesht ndarja e shkresës do të bëhet në dy pjesë. Pjesa e fushëveprimit të Komisionit është fushë e një komisioni në Kuvend, si e veçantë. Kurse, sa i përket strukturës së Komisionit, me shumicë votash ia kemi rekomanduar Kryesisë së Kuvendit, sipas të cilit Komisioni mendon se të qenit anëtar në dy komisione është konflikt interesi. Ka pasur edhe anëtarë që ishin kundër. Kjo është konstatuar në rekomandim. Këtë vendim nuk do ta diskutojmë në mbledhje, sepse është çështje e kryer, por deshëm vetëm t'ju njoftojmë për ndryshimet - ndarja e pjesës për Kryesi dhe për fushëveprimin e Komisionit për Komisionin për Mandate dhe Imunitete.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Haki Shatri